

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha procesmbajtëse, në çështjen penale të dënuarit I.Sh., nga P., për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të ushtruar nga i dënuari, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.145/16 të datës 09.02.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.214/2017 të datës 08.06.2017 në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 07.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit I.Sh., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.145/2016 datë 09.02.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.214/2017 datë 08.06.2017.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj me aktgjykimin PKR.nr.145/2016 të datës 09.02.2017, të dënuarin I.Sh. e ka shpallur fajtor për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2 të KPRK, dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Është obliguar i dënuari që të dëmtuarit H. B. në emër të kërkesës pasurore juridike ti kthej shumën prej 500 (pesëqind) euro, në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Është obliguar i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 euro, në afat prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.214/2017 të datës 08.06.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të dënuarit dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve në afatin ligjor, i dënuari ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë ta anuloj dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Prokurori i shtetit me parashtrësën KMLP.II.nr.157/2017 të datës 11.09.2017, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

Kërkesa e të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë rezulton se i dënuari, e kundërshton gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e cila është vërtetuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me pretendimin se kjo gjykatë fare nuk e ka marr për bazë mbrojtjen e të dënuarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor e as provat e tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, me të cilat prova kishte mu vërtetuar se i njëjti nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Gjykata Supreme vlerëson se në rastin konkret, kërkesa e të dënuarit i referohet vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Megjithatë, edhe pse si bazë juridike të këtij mjeti juridik qëndron vërtetimi i gabuar dhe jo i drejtë i gjendjes faktike nga referati i kërkesës rezulton se kërkesa i referohet edhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale meqë potencohet se vlerësimi i provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor në veçanti mbrojtja e të dënuarit dhe si rezultat i vlerësimit të gabuar të provave, edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë.

Kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimet e kundërshtuara janë të qarta dhe konkrete, në to janë dhënë arsye faktike dhe juridike për të gjitha faktet relevante. Vlerësimi i provave në veçanti mbrojtja e të dënuarit ,provat tjera materiale, raporti i ekspertizës i dt.20.01.2014, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve, shikimi në bankënotën 500 euro, me nr. serik x06449626775, është bërë në harmoni me dispozitat e nenit 361 par.2 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK, për çfarë te dy gjykatat kanë dhënë arsye të qarta ligjore të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Vlen të theksohet se konkludimet e të dy gjykatave lidhur me përshkrimin faktik dhe cilësimin juridik të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor është rezultat i vlerësimit drejtë të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor kështu që asnjë fakt nuk ka ngelur dubioz ose i pavërtetuar dhe si rrjedhojë, drejt është aplikuar ligji penal.

Nga të gjitha këto që u thanë më lart, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit, andaj kërkesa e të dënuarit është refuzuar si e pabazuar dhe konform nenit 437 të të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
Më 07.03.2018, Pml.nr.230/2017

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Emine Mustafa